



Datë: 09.01.2026
Numër Protokolli: 188/2026

A.nr.2053/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2053/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesja A.ZH-H, kundër organit të punësimit MPJD, në çështjen juridike “*kompensim material*” duke vepruar sipas nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.2053/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesja A.ZH-H.

II. Çështja bije në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesja A.ZH-H (*tutje referuar ankuesja*), më datë 22.12.2025, përmes emailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 22.12.2025, nën shenjën A.nr.2053/2025, për shkak të mos kompensim material për përvojën e punës dhe neutralizim të rritjes së pagës përmes zvogëlimit të shtesave diplomatike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.2053/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesja, *sepse*:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit, të datës 19.01.2017, ka qenë e punësuar në pozitën *Udhëheqëse e Departamentit për Çështje Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme*, ndërsa, e njejta më Dekretin nr. 987/1, të datës 30.09.2021 të Presidentes të Republikës së Kosovës, është emëruar Ambasadore/Shefe e Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Mal të Zi, emërin ky që bazohej në nenin 84, paragrafi 4, 10 dhe 25 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe nenit 7 të Ligjit Nr.03/044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon për moszbatimin e Aktgjykimit KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës- kompensimin për përvojën e punës dhe neutralizim të rritjes së pagës përmes zvogëlimit të shtesave diplomatike. Kërkon që të aprovet ankesa dhe të obligohet MPJD-në për ri-llogaritjen e përvojës së punës me efekt retroaktiv nga 01.02.2023 si dhe të sigurojë kompensimin e diferencën e pagës deri me 31.12.2025.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës materiale të Këshillit lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen në këtë çështje juridike-administrative, Kolegji iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 3, paragrafi 1, ku parashihet së: *1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim: 1.1. të zgjedhurat/it; 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendëset/it e tyre; 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullarët/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji...*, si dhe nenit 7 të Ligjit Nr.03/044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: *7.1. Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret*” dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor funksionarët publikë të emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, nuk kanë statusin e nëpunësit civilë dhe si të tillë janë të përjashtuar nga fusha e zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Nisur nga konstatimi si me sipër, e duke qenë se ankuesja me rastin e parashtrimin të ankesë është duke e ushtruar pozitën e ambasadores sipas Dekretit me numër 987/1 i datës 30.09.2021, rrjedhë fakti se ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil, andaj përgjatë ekzistimit të kësaj gjendje statusore, Këshilli nuk ka kompetencë lëndore që të vendos lidhur me kontestet administrative të iniciuara nga ankuesja në cilësi të ambasadores, kështu që, në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji erdhi në përfundimin se Këshilli nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses A.nr.2053/82025, të datës 22.12.2025.

Pas konstatimit së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.2053/2025, të datës 22.12.2025, për shkak statusit aktual të ankueses si funksionare publike, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në konstatimet e Gjykatës Kushtetuese sipa Aktgjykimt në rastin nr. KI214/21 të datës 06.01.2023 si dhe në mbështetje të nenit 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Rrjedhimisht, në rastin konkret, çështja nuk mund ti delegohet gjykatës kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2053/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.ZH-H ;
- Organit të punësimit: Ministres dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MPJD; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.